Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

www.inca-al.org













INFORMIMI DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I LIVADHEVE TË POSIDONIA OCEANICA NË SHQIPËRI









<u>Përmbajtja.</u>

Konsulentët	2
Projekti	3
Hyrje	4
Instalimi i GIS	5
Përdorimi i GIS	9
Përdorime të tjera	15
Dokumente ndihmëse	15

KONSULENTET

Prof. Dr. Lefter Kashta Dr. Saimir Beqiraj Dr. Zamir Dedej Dr. Genti Kromidha Znj. Albana Zotaj Z. Niko Hyka

PROJEKTI

Projekti "Informimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i livadheve të Posidonia-s" zbatohet që nga viti 2007. Ky projekt është financuar nga Ministria e Jashtme Italiane dhe zbatohet nga një OJF Italiane (GAO) në bashkëpunim me Institutin për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, për inventarizimin e *Posidonia oceanica* në brigjet shqiptare.

Projekti i përfunduar është mbështetur mbi të dhënat e marra për livadhet e Posidonia-s në bregdetin shqiptar dhe hartat e përgatitura. Nëpërmjet përpunimit të versioneve të thjeshta për përdorim është bërë e mundur përgatitja e DVD-së, manualit shoqërues, librushkës dhe fletëpalosjeve me mbështetjen e GEF/SGP.

Hyrje

Sistemi i informacionit gjeografik (GIS) i krijuar në kuadër të projektit "Informimi dhe menaxhimi i livadheve të *Posidonia oceanica* në Shqipëri " është një instrument që bën të mundur konsultimin interaktiv të të dhënave të mbledhura gjate zhvillimit të aktiviteteve të projektit.

Në brendësi të aplikimit GIS janë grumbulluar në një strukturë të vetme shtresa informacioni *(layers)* në lidhje me:

- Livadhet e *Posidonia oceanica* përgjatë bregdetit shqiptar, të klasifikuara sipas tipologjisë,
- Pikat e rilevimit biologjik
- Pikat e kalimit të ROV (Remote Operated Vehicle)
- Vija batimetrie
- Të dhëna të tjera mbi territorin e Shqipërisë.

Aplikimi GIS veç të tjerash përmban edhe një sërë dokumentesh të lidhura me rilevimet e kryera në terren, si:

- të dhëna, tabela dhe grafikë mbi livadhet e Posidonia oceanica
- Fragmente të filmimeve të ROV
- Fotografi të zonave me interes ku janë kryer rilevimet biologjike

Përdorimi i aplikimit GIS është shumë i thjeshtë, lejon shqyrtimin e informacioneve të projektit me shpejtësi dhe mund të konsiderohet si një instrument i vlefshëm për mbështetjen e vendimmarrjes.

Aplikimi ka një strukturë të hapur që lejon integrimin e informacioneve të reja që mund të grumbullohen në të ardhmen.

INSTALIMI I GIS

Për të instaluar përmbajtjen e DVD veprohet si më poshtë: Fusni DVDnë e dhënë në lexuesin përkatës. Në ekran shfaqet për disa sekonda faqja prezantuese e projektit. Për shqyrtimin e të dhënave të Sistemit të Informacionit Gjeografik mbi livadhet e *Posidonia oceanica* në Shqipëri është e nevojshme që ju të keni të instaluar programin ArcReader 9.3.1, i cili është i përfshirë në DVD dhe mund të instalohet automatikisht nëse ju doni. Për të evituar konfliktet me versionet e tjera të ArcReader Ju lutemi të testoni fillimisht nëse ka ndonjë problem për instalimin e programit ArcReader 9.3.1 në kompjuterin tuaj. Nëse dëshironi të testoni klikoni "PO" në tabelën që ju shfaqet në ekran.

Testoni	
٩	Perdorimi i materialit të DVD kërkon të keni të instaluar në kompjuterin tuaj programin ArcReader 9.3.1. Ju lutemi testoni fillimisht nëse ka ndonjë problem për instalimin e këtij programi në kompjuterin tuaj. Dëshironi të testoni?
	20
Daci t	ä jetä kryer kontrolli dhe eliminuar problemet do t'iu shfaqet r

Pasi të jetë kryer kontrolli dhe eliminuar problemet do t'ju shfaqet një tabelë që ju kërkon të instaloni ArcReader 9.3.1. Klikoni tek "PO" për të vazhduar me procedurat e instalimit të programit ArcReader 9.3.1.

Instaloni programin ArcReader 9.3.1		
(į)	Nëse përdorni për herë të parë këtë DVD, ju duhet të instalori ArcReader në kompjuterin tusj. Dëshironi të instaloni ArcReader 9.3.1? Nëse po ju lutemi klikoni "Yes" dhe nëse jo klikoni "No" për të vazhduar ekplorimin e CD.	
	<u>Po</u> <u>lo</u>	

Në përfundim të instalimit hapet faqja kryesore e DVD-së (figura) e cila përmban një listë me mundësi për instalimin e të dhënave të Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) mbi *Posidonia oceanica* në Shqipëri.

INCA



Instalim manual i programeve.

Ju jep mundësinë që në mënyrë manuale të instaloni në kompjuterin tuaj programet e përfshira në DVD. Pasi të klikoni shfaqet:

- Instalo ArcReader 9.3.1 (instalon programin në kompjuterin tuaj)
- Instalo Acrobat Reader (instalon programin në kompjuterin tuaj)
- Kopjo materialet nga CD (shih më poshtë)
- Shfleto CD (shfaqet përmbajtja e DVD)
- Kthehu pas (kthehet në menynë e mëparshme)

Manuali i përdorimit

Demonstrim për përdorimin e DVD-së

Pasi të klikoni shfaqet:

- Manuali i përdorimit (Ky manual në format pdf)
- video për përdorimin e DVD)
- Broshura (Broshura me të dhënat mbi projektin dhe Posedonia oceanica në Shqipëri në format pdf.)
- Kthehu pas (kthehet në menynë e mëparshme)



Ekzekuto nga DVD

Klikoni për të ekzekutuar aplikimin GIS direkt nga DVD-ja.

Kopio materialet.

Për të qenë të pavarur nga DVD duhet që të dhënat e DVD-së të kopjohen në kompjuterin tuaj. Pasi të keni klikuar mbi këtë opsion do t'ju shfaqet një tabelë që ju kërkon të konfirmoni nëse doni të kopjoni të dhënat në kompjuterin tuaj. Klikoni "PO" për të kopjuar të dhënat.



Shpejtësia e kopjimit varet nga parametrat e kompjuterit tuaj dhe mund të zgjasë nga 3-10 minuta. Pasi të përfundojë kopjimi i të dhënave, programi ekzekutohet automatikisht dhe hapet ArcReader me të dhënat e Posidonias. Nëse klikoni mbi këtë opsion pasi keni kopjuar të dhënat ju hapet direkt aplikimi GIS me të dhënat e Posidonia-s.

Kjo komandë do të kopjojë në kompjuterin tuaj (në **rrënjën** C:) skedarët **DATA, PMF, SURVEY DATA**, të nevojshëm për funksionimin e aplikimit GIS. Programi fillon duke klikuar mbi **Posidonia.pmf** që ndodhet në skedarin PMF.

Nëse doni që të keni akses më të thjeshtë mbi këtë aplikim pa vajtur gjithmonë tek skedari PMF mund të krijoni një shortcut të Posidonia.pmf dhe këtë më pas dërgojeni në Desktop-in tuaj. Kështu mund të keni askes të menjëhershëm në aplikimin GIS për *Posidonia oceanica* në Shqipëri.

Ekzekuto Posidonia

Fillimisht duhet të kopjohen të dhënat në kompjuterin tuaj. Pas kësaj, kur të klikoni mbi këtë opsion do të hapet ArcReader me të dhënat e Posidonias. Me këtë opsion ju mund te hapni aplikimin GIS sa herë që fusni DVD në kompjuterin tuaj.

Shfleto DVD

Shfleto përmbajtjen e DVD-së në programin Explorer.

Mbyll DVD

Manuali i përdorimit

PERDORIMI I GIS

Përdorimi i aplikimit GIS është i thjeshtë dhe lidhet kryesisht me instrumentet qe mund të përdoren për të eksploruar dhe konsultuar informacionet e grumbulluara gjatë fazave të ndryshme të projektit. Në figurë paraqitet dritarja kryesore e aplikimit GIS, siç duket kur programi hapet për herë të parë.



Figura 1: Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS)

INCA

Pjesa majtas e dritares kryesore është kuadrati (*frame*) ku janë listuar shtresat e informacionit (*layers*), ndërsa pjesa në të djathtë është dritarja ku shfaqet përmbajtja e informacionit gjeografik.

Si zakonisht për këtë tip aplikimi, shtresat mund të aktivizohen ose çaktivizohen për të marre pamjen e informacionit që dëshirohet. Pjesa e sipërme e dritares përmban instrumentet kryesore për shqyrtimin dhe konsultimin e të dhënave.

Instrumentet kryesore për t'iu referuar informacioneve të grumbulluara ne GIS janë rigrupuar në "shiritin e veglave".



Figura 2: Shiriti i veglave kryesore për shqyrtimin e informacioneve

Nëpërmjet këtyre instrumenteve, përdoruesi ka mundësinë të zhvendosë zonat në ekran, të zmadhojë zona të caktuara, të kryejë matje, të lokalizojë zonat me interes të veçantë, të konsultojë materialet shtesë (grafikë, foto, etj) për çdo zonë, etj.

Përmes butonit "zoom"(()) bëhet e mundur zmadhimi i një pjesë të caktuar të hartës, duke lejuar shfaqjen e më shumë detajeve nga ajo pjesë e hartës. Në shembullin më poshtë, kemi përzgjedhur të zmadhojmë zonën përreth Porto Romanos (fig 3) e cila paraqitet në detaje në Fig 4.



Figura 3: Zgjedhja e zonës së Porto Romanos nëpërmjet instrumentit "zoom +"

Figura 4: Pamje e zmadhuar e zonës së Porto Romanos

Instrumenti "Measure" (iso ne alizimin e matjeve (në metra) në pjesë të ekranit. Në foto ilustrohet matja e gjatësisë se një livadhi me *Posidonia oceanica* në zonën e Porto Romanos.



Figura 5: Matja e gjatësisë së livadhit te P. Oceanica në zonën e Porto Romanos

Instrumenti "hyperlink" (^{\$\mathcal{F}}) përdoret për të konsultuar informacionet bashkëlidhur sistemit te informacionit gjeografik. Dokumentet e lidhura me këtë aplikim janë: filmime (në format AVI), fotografi, të dhëna e grafikë të rilevimeve biologjike, etj.



Triggers hyperlinks from features

Figura 6: Shfaqja e një video filmuar gjatë kalimit të ROV



Figura 8: Shqyrtimi i tabelës së të dhënave dhe fotove

Manuali i përdorimit

Përdorime të tjera

Programi ArcGIS ArcReader përmban një sërë funksionesh të tjera për shqyrtimin dhe analizimin e informacioneve që ndodhen në sistemin gjeografik të informacionit (GIS). Për një përshkrim më të detajuar të funksioneve të përdorshme ju këshillojmë të lexoni udhëzuesin on-line të programit ArcGIS Arc Reader që gjendet në menynë "Help" të këtij programi.

Dokumente ndihmëse

Në DVD është përfshirë, përveç informacioneve gjeografike mbi shpërndarjen e *Posidonia oceanica* në Shqipëri, edhe një broshurë me informacione më të detajuara mbi projektin për hartëzimin e livadheve të *Posidonia oceanica* në Shqipëri si dhe rezultatet kryesore të punës së kryer. Kjo broshurë është dhënë në formatin pdf dhe mund të konsultohet lehtësisht nga përdoruesit.

Gjithashtu, edhe ky manual përdorimi, në format pdf, është përshirë në DVD me qëllim që përdoruesit ti referohen atij në çdo kohë që e gjykojnë të nevojshme.



Kërkesat minimale të kompjuterit tuaj për instalimin e aplikimit GIS janë:

- Procesori tipi Pentium IV, ose më shumë, mbi 1 GHz;
- 512 MB RAM ose më shumë;
- HDD 20 GB ose me shumë, dhe minimumi 5 GB të lira;
- Skede grafike OpenGL me të paktën 128 MB

Programet e kërkuara për përdorimin e GIS janë:

- Sistemi Operativ Windows 2000, XP, ose Vista;
- Microsoft Windows Media Player 9.0 ose Apple QuickTime 6.5.1;
- Adobe Acrobat Reader 6.0 ose më shumë

DVD përmban ArcGIS Reader 9.3.1

Përgatitur nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri në kuadër të projektit "Inventarizimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i livadheve të *Posidonia oceanica* në Shqipëri".

Përgatitja e kësaj DVD-je dhe gjithë materialeve mbështetëse u mundësua falë financimit të GEF/SGP Albania.





Manuali i përdorimit